

ANILA KRUTI
FLUTURA E MAJIT
NOVELËZ

BOTIMET TOENA



Anila Kruti

*Flutura
e majit*

novelëz

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Kujtim Dashi

Korrektore letrare: Edona Marku

Ilustrimet: Anila Kruti

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-43-5

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Një ditë jetë...

Flutura e Majit

Kaltra ishte në kopsht me gjyshen. Po vështronte qershitë. Ato vende-vende ishin skuqur. Përreth zukatnin bletët dhe vendi ishte mbushur me flutura. Kishte aq shumë flutura me ngjyra, të bardha të kuqe, të verdha. Më tej, kopshti ishte mbushur me lule dhe me qershi, nga të gjitha anët. Ishte pranverë. Kaltra po ndihmonte gjyshen në kopsht mbi karrocën me rrota. Kishte pothuaj gjithë mëngjesin që po pastronin kopshtin. Mendja i shkoi te nëna. Sa shumë e kishte marrë malli për të! Vështroi nga qielli.

- Ajo po më shikon nga diku, - mendoi. Vërejti fustanin me pala të kuqe, që ia kishte qepur nëna. E mbështolli pas trupit. Një flutur e kaltër po i sillej rrotull. E pa e habitur. Nuk kishte parë flutur aq të madhe e të bukur me krahë të mëdhenj të shndritshëm.

- Ua! - pëshpëriti Kaltra e habitur dhe po e ndiqte me sy. Në ato çaste u dëgjua zëri i gjyshes.





- Kaltra, Kaltra... shko merr ujë të ftohtë brenda, -
foli ajo duke fshirë ballin me duar.

Kaltra u përmend nga ajo përhumbje e ëmbël, u
nis duke shtyrë karrocën me rrota drejt shtëpisë, që
ishite shumë pak metra larg saj. Teksa bëri të hynte në
kuzhinë, sytë i shkuan te sënduku i gjyshes. E shtyu



kureshtja dhe shkoi drejt tij. Sa herë kishte ëndërruar ta hapte atë sënduk! Çfarë thesaresh mbante gjyshja në atë sënduk? Do të kishte aty brenda zogj, flutura, pemë, burime, siç kishte menduar ajo? Me siguri duhet të jenë atje, përderisa gjyshja i fsheh, - mendoi.

U step një çast dhe, më pas, ndërkohë që kujtoi ato mrekullitë e natyrës, u gjend përpara sëndukut. Ngriti lart kapakun e tij dhe e mbështeti për mur. Vështroi brenda e habitur. Aty nuk kishte zogj, flutura, pemë. Aty kishte thesare. Vazo të zbukuruara, shishe të mbushura me pije të ëmbla, gliko me arra, manaferra, fustane të bukura të gjyshes nga rinia e saj. Dhe shumë gjëra të tjera, që e mahnitën Kaltrën. Dora i shkoi te një kutizë e vogël ngjyrë blu. E hapi ngadalë. Ç'të shihte! Ishte një copë letër dhe poshtë saj mezi shquhej një karficë me gurë të shndritshëm.

Tërhoqi letrën dhe u duk karfica e bukur dhe e shndritshme, që vezullonte.


E mori në dorë. Po vështronte vezullimin me habi, kur befas dhoma u mbush me flutura. Ato e rrethuan dhe rrotulloheshin rreth saj duke bërë dritë me ngjyra magjike. Një flutur e madhe, me ngjyrë të kuqe iu afrua Kaltrës. I mori



karficën dhe e vuri mbi flokët e saj. Gjithçka rreth e rrotull u bë e shndritshme me ngjyra ylberi. Mbylli sytë. U gjend në një kopsht me trëndafila. Po fluturonte mbi një trëndafil të kuq të madh. Ishte një flutur. Sytë i shkuan mbi një pegg të vogël. Vështroi e habitur veten. Ishte një flutur



e madhe e kaltër më krahë rozë dhe të kuq, si petale. Në dorë i kishte mbetur letra. Ngaqë ajo nuk kishte mundur ta lexonte, e kishte mbajtur në dorë, kur kishte ndodhur magjia.



Është letra e nënës sime mendoj dhe e mbështolli me dashuri në kraharor, afër zemrës. Vështroi këmbët. I kishte të holla si degët e trëndafililit. Nuk u besoi syve. E pa edhe njëherë veten në pasqyrën e ujit. U përlot. Kishte këmbë dhe krahë.

